



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2020 Prot.

Durrës, më 30.10 2024

VENDIM
Nr 16, datë 30.10.2024

PËR

“ MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË KUOTAVE TË PAPLOTËSUARA NË PROGRAMIN E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE MASTER SHKENCOR “MBROJTJA E MJEDISIT DETAR DHE MENAXHIMI I TIJ”, PRANË FAKULTETIT TË STUDIMEVE PROFESIONALE TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS”, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 36, neni 37, pika 1,3,4,5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 “Për riorganizimin e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës”, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, të urdhërit të përbashkët Nr. 112, datë 05.07.2024 “Për miratimin e kalendarit dhe procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2024-2025”, bazuar në shkresën përcjellëse të FSP me Nr. 1010/8 prot, datë 28.10.2024, të shkresës Nr. 2009 prot, datë 30.10.2024, të Drejtorisë së Kurrikulave të Standarteve të Cilësisë, të Statutit të UAMD-së, të Rregullores së UAMD-së, Senatit Akademik i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës”,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishpërndarjes së kuotave të paplotësuara në programin e ciklit të dytë të studimeve master shkencor “Mbrojtja e mjedisit detar dhe menaxhimi i tij”, ku 5(pesë) kuota të vecanta nga Trojet kalojnë në kuota brenda vëndit pranë Departamentit të Shkencave Inxhinjerieke dhe Detarisë, në Fakultetit të Studimeve Profesionale të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës”, për vitin akademik 2024-2025.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen:
 - Zv.Rektorët,
 - Administratori,
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore,
 - Drejtuesi i njësisë Bazë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

